



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.484/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në çështjen juridike të paditësit M.G. dhe “NTP Kosova Tobacco” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, të përfaqësuar nga Sh.N. dhe L.G. sipas autorizim të datës 30.04.2024, kundër të paditurës Policia e Kosoves, rr. "Luan Haradinaj" pn, Prishtine, Kosove, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me kërkesë padi për anulimin vendimit Nr.293/19 të datës 12.12.2019, jashtë seancës me datën 28.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Departamenti për Çështje Administrative, Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, shpallet JO KOMPETENT, për të vendosur sipas padisë të paditësit M.G. dhe “NTP Kosova Tobacco” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Policia e Kosoves, rr. "Luan Haradinaj" pn, Prishtine, Kosove, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar, për anulimin vendimit Nr.293/19 të datës 12.12.2019.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi dosja e lëndës me nr. KA.nr. 190/24 më të gjitha shkresat e saj i dërgohet DEPARTAMENTIT FISKAL të Gjykatës Komerciale.

A r s y e t i m

Me datë 20.01.2020 paditësit M.G. dhe “NTP Kosova Tobacco” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, të përfaqësuar nga Sh.N. dhe L.G. sipas autorizim të datës 30.04.2024, kanë parashtruar padi kundër të paditurës Policia e Kosoves, rr. "Luan Haradinaj" pn, Prishtine, Kosove, Ministria e Financave,

Punës dhe Transfereve, Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar, me kërkesë padi për anulimin vendimit Nr.293/19 të datës 12.12.2019.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata vlerësoj se vendimi i kundërshtuar është nxjerrë nga e paditura Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar, për të cilën është kompetent Departamenti Fiskal i kësaj gjykate, sipas Ligjit (NR. 08/L-015) për Gjykatën Komerciale, Neni 13 ku përcaktohet kompetenca e Gjykatës Komerciale me juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë, si dhe kompetenca e secilit departament në Dhomat e Shkallës së Parë. Sipas paragrafit 4. *Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.11 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti Fiskal; e që në nën-paragrafin 1.11. kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të Administratës Tatimore, Autoriteteve Doganore, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve të tjera shtetërore.*

Me vendimin e kundërshtuar paditësit i shqiptohet gjobe për mosrespektim të Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (Nr. 04/L-014), për të cilin detyrim është përgjegjëse e paditura, dhe ky detyrim përcaktohet në dispizitën e cituar më lart “ose detyrimet e tjera shtetërore”, që nënkupton së përveç detyrimeve tatimore të përcaktuara ma ligj, në kompetencë të Departamentit Fiskal hyjnë edhe detyrimet e tjera shtetërore për të cilat është përgjegjëse e paditura.

Ndërsa, në Departamentin për çështje administrative, në shkallë të parë sipas paragrafit 5, të njëjtit Nen hyjnë *kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative të përcaktuara në nën-paragrafin 1.12 të njëjtit Nen.*

Për arsyet e cekura më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe nenit 13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.484/22, datë 28.04.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.